

VENDIM

PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot, me date 22.1. 2001, une gjyqtarja e Gjykates se rrethit Tirane, pasi u njoha me materialet dhe kerkesen e paraqitur nga Alma KRAJA e cila kerkon regjistrimin si person juridik te shoqerise "AlbAtlas" sh.p.k.

KONSTATOVA

Se kerkesa e paraqitur nga kerkuesja Alma KRAJA eshte ortake e vetme dhe Administratore e shoqerise "AlbAtlas" sh.p.k., me seli ne Tirane rr." M.Peza", duke qene une Ortake e vetme e kesaj shoqerise, e cila do te kete aktivitetin e saj ne fushen e : negocimit dhe organizimit te turizmit si agjensi turistike te te huajve ne vendin tone dhe te vendasve ne vendet e huaja, perfshire ketu, hotelerine, ushqimin dhe transportin, duke bashkepunuar me agjensite e tjera turistike te vendit dhe te huaja, shitblerjen e biletave per udhetime ajrore , tokesore dhe detare, sherbime rent a car, si edhe aktivitete te tjera qe do te konsiderohen te pershtatshme per zhvillimin e shoqerise Kapitali fillestar e kesaj shoqerise eshte 100.000 leke, me nje kohezgjatje te aktiviteti deri 10 vjet .

Meqenese kerkesa e paraqitur prej saj eshte e drejte dhe e bazuar si e tille ajo duhet pranuar.

PER KE TO ARESYE

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1994 per "Shoqerite tregtare"

VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

Regjistrimin si person juridik te shoqerise "AlbAtlas" sh.p.k.me ortak te Vetem dhe Administrator te kesaj shoqerie z. Alma KRAJA, me seline e saj ne me seli ne Tirane rr." M.Peza", duke qene une Ortake e vetme e kesaj shoqerise, e cila do te kete aktivitetin e saj ne fushen e : negocimit dhe organizimit te turizmit si agjensi turistike te te huajve ne vendin tone dhe te vendasve ne vendet e huaja, perfshire ketu, hotelerine, ushqimin dhe transportin, duke bashkepunuar me agjensite e tjera turistike te vendit dhe te huaja, shitblerjen e biletave per udhetime ajrore , tokesore dhe detare, sherbime rent a car, si edhe aktivitete te tjera qe do te konsiderohen te pershtatshme per zhvillimin e shoqerise Kapitali fillestar e kesaj shoqerise eshte 100.000 leke, me nje kohezgjatje te aktiviteti deri 10 vjet .

Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Tirane.
Tirane, me 22.1. 2001

GJYQTARE

Majlinda Gjyq
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
 GJYKATA E RRETHIT TIRANE
 RREGJISTRI TREGTAR

URDHER RREGJISTRIMI

Kolona I	Numer i Rregjistrimit tregtar <u>25015</u>
Kolona II	A. Emri i Shoqerise <u>Alb Atlas s.p.k</u> B. Selia <u>Buzare Nr M. Peza,</u> C. Objekti <u>shpallim, tregim si shpallim tregu</u> <u>shpallim tregu tregim me vendim tregu</u> <u>shpallim tregu tregim me vendim tregu</u> D. Kapitali <u>100.000 leke</u>
Kolona III	A. Ortaket <u>Alma Buzare e Bysë Osmanit</u> <u>ditë 1965 Buzare Buzare</u> B. Administratoret: <u>Ortaket e Buzare</u>
Kolona IV	Kohe zgjatja <u>mbi 10 vjet</u>
Kolona V	Shenime mbi aktet e shoqerise A. Data e nenshkrimit <u>17. 1. 2001</u> B. Data e rregjistrimit <u>22. 1. 2001</u> C. Statuti flete <u>6 flete</u> D. Akti i Themelimit flete <u>2 flete</u>

Shenime: shpallim tregu tregim me vendim tregu Vilandra Buci

GJYQTARE
(Signature)

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR



“AlbAtlas” sh.p.k.

Ne Tirane, sot, me date 17 Janar 2001 zj.ALMA KRAJA banuese ne Tirane, madhore me zotesi juridike dhe per te vepruar deklarom ne kete akt themelimi si me poshte:

NENI 1

Ortaku i vetem zj. ALMA KRAJA ka vendosur krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e cila emertohet “AlbAtlas” sh.p.k.

NENI 2

Kjo shoqeri me pergjegjesi te kufizuar eshte person juridik ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe aktiviteti i saj rregullohet sipas dispozitave te statutit te kesaj shoqerie dhe duke u bazuar edhe ne kete akt themelimi si dy akte baze te kesaj shoqerie.

NENI 3

Qendra e kesaj shoqerie do te jete ne Tirane, rr.”M.Peza”, me te drejte per te ndryshuar qendren e saj si edhe per te hapur dege dhe filiale te tjera ne te gjithe Republiken e Shqiperise si edhe jashte saj ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.

NENI 4

Kapitali fillestar i kesaj shoqerie do te jete i peregjere nga nje shume prej 100.000 leke i cili perben kontributin e ortakut te vetem te kesaj shoqerie.

NENI 5

Kohezgjatja e aktivitetit te kesaj shoqerie do te jete mbi 10 vjet. Por kjo shoqeri mund te shperbehet edhe para mbarimit te ketij afati sipas rasteve te parashikuara ne statutin e kesaj shoqerie (shperberja dhe likuidimi).

NENI 6

Objekti i aktivitetit te kesaj shoqerie eshte percaktuar me hollesi ne nenin 4 te statutit te kesaj shoqerie. Keshtu konkretisht kjo shoqeri do te ushtroje aktivitetin e saj ne fushen e :negocimit dhe organizimit te turizmit te te huajve si agjensi turistike ne vendin tone dhe te vendasve ne vendet e huaja, perfshire ketu, hotelerine, ushqimin dhe transportin, duke bashkepunuar me agjensite e tjera turistike te vendit dhe te huaja, shitblerjen e biletave per udhetime ajrore , tokesore dhe detare, sherbime rent a car, si edhe cdo veprimtari tjeter qe i sherben rritjes dhe zhvillimit te kesaj shoqerie.

NENI 7

Fillimin e aktivitetit te saj tregtar kjo shoqeri e lidh me regjistrimin e saj ne regjistrin tregetar te Gjykates se rrethit Tirane si edhe me paisjen me licencen perkatese nga Zyra e Tatimeve.

NENI 8

Aktiviteti ekonomik dhe investimet e kesaj shoqerie mbrohen nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

NENI 9

Administrator i kesaj shoqerie do te jete Ortaku i vetem i kesaj shoqerie zj. Alma KRAJA, e cila ushtron dhe ndjek aktivitetin e shoqerise se krijuar prej saj, duke zbatuar edhe kompetencat perkatese sipas dipsozites perkatese te statutit.

NENI 10

Per ruajtjen dhe sigurimin e pasurive te saj te luajtshme dhe te paluajtshme kjo shoqeri mund t'i drejtohet INSIG-ut ne qender dhe deget e tij.

NENI 11


Dispozita me te hollesishme jane parashtruar ne statutin e kesaj shoqerie e cila shpreh vullnetin e lire te themeluesit.

SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“AlbAtlas“ sh.p.k.

ORTAKU I VETEM

(ALMA KRAJA)



Alma Kraja

STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“AlbAtlas” sh.p.k.

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “AlbAtlas” sh.p.k., themelohet ne perputhje me ligjin 7638 date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”. Kjo shoqeri krijohet nga ortake e vetme z.Alma KRAJA, e bija e Osmanit, e dtl.1965, lindur dhe banues ne Tirane. Ortakja e lartpermendur vendos krijimin e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar te emertuar “AlbAtlas” sh.p.k..

NENI 2

Shoqeria “AlbAtlas” sh.p.k. e zhvillon veprimatrine e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe dipsozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj (Akti i themelimit dhe Statuti i shoqerise).

Shoqeria “AlbAtlas” sh.p.k. eshte person juridik. Ajo e fiton kete te drejte si person juridik nga data e regjistrimit te kesaj shoqerise ne regjistrin tregtar te Gjykates se rrethit Tirane. Kjo shoqeri do ta kete seline e saj ne.


NENI 3

Shoqeria “AlbAtlas” sh.p.k. krijohet per te ushtruar aktiviteitn e saj per njekohezgjatje mbi 10 vjet. Kjo shoqeri mund te zgjase afatin e saj te veprimtarise se saj ose mund te mbylle aktivitetin e saj edhe para mbarimit te ketij afati, e realizuar kjo sipas dipsozitive qe percaktohen ne kete statut dhe sipas kriterëve qe percaktohen ne legjislacionin ne fuqi.

NENI 4

Shoqeria “AlbAtlas” sh.p.k., per detyrimet qe do te lindin gjate aktivitetit te saj me te tretet pergjigjet vetem me pasurite e saj. Ortaku i kesaj shoqerise nuk pergjigjet per deturimet e kesaj shoqerise me pasuritee tij qe nuk jane futur ne kapitalin e kesaj shoqerise. Pjesmarrja ne kete shoqeri nuk e pengon ortakun te kete pavaresi ligjore, organizative dhe te drejta pronesia jashte kesaj shoqerise.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE



NENI 5

Shoqeria "AlbAtlas" sh.p.k. do te ushtroje aktivitetin e saj ne fushen e negocimit dhe organizimit te turizmit si agjensi turistike te te huajve ne vendin tone dhe te vendasve ne vendet e huaja, perfshire ketu, hotelerine, ushqimin dhe transportin, duke bashkepunuar me agjensite e tjera turistike te vendit dhe te huaja, shitblerjen e biletave per udhetime ajrore , tokesore dhe detare, sherbime rent a car, si edhe cdo veprimtari tjeter qe i sherben ritijes dhe zhvillimit te kesaj shoqerie.

KAPITALI THEMELTAR

NENI 6

Kapitali themeltar i kesaj shoqerie perbehet ne te holla ne nje vlere prej 100.000 leke (njeqindmije). Ky kapital themeltar zoterohet nga ortakut i kesaj shoqerie ne menyre te plote ne masen 100 % .

Kapitali themeltar ose pjese te caktuara te tij jane te transferueshme nga ortakut i kesaj shoqerie perkundrejt personave te trete. te gjitha veprimet e shoqerise mbi kapitalin themeltar ne natyre behen me miratimin e te gjitha ortakëve. Vleresimi i ketij kapitali behet nga ortakut i shoqerise dhe me vendim te ortakut te vetem dhe nga nje ekspert kontabel i caktuar nga vete ortakut.


NENI 7

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 pjese ku njera pjese eshte e barabarte me 1000 leke (njemije). Zmadhimi ose zvogelimi i ketij kapitali vendoset nga Ortakut i vetem. Kapitali i shoqerise mund te shtohet me vendim unanim te Ortakut te vetem i cili do te percaktoj formalitete per pranimin e pjesmarresve te rinj. Per cdo pjesmarres te ri qe do te pranohet, shoqeria jep nganjë vertetim per numrin e kuotave qe zoteron dhe vleren nominale te tyre. Ne rast se kuotat e kapitalit te shoqerise transferohen ne favor te nje personi te trete, ai merr automatikisht te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe ka ortakut qe dorezon kuotat, pra qe largohet, perfshi edhe ato lloj detyrimesh qe ortakut shites ka marre mbi vehte duke firmosur kontraten per themelimin e shoqerise. kete gje ai duhet ta pranoje duke iu dhene konfirmimi me shkrim ortakëve te tjere te shoqerise. Ne se nuk do te behet ky konfirmim me shkrim, shitja e kuotave nje personi te trete konsiderohet e pavlefshme. Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne baze te nje pavaresie te plote ekonomike. Ajo nuk pranon asnje nderhyrje nga organet shteterore apo publike te cfaredo lloji qofshin, perjashtuar kontrollit qe ka te drejte te bejne organet shteterore ne baze te ligjit ne fuqi.

KREU II

ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 8



Organi me i larte vendimor i shoqerise eshte Ortaku i Vetem.
Ortaku i vetem ka te drejte te marre pjese personalisht apo duke autorizuar me shkrim nje person tjetër duke mos qene ortak ne kete shoqeri. Ortaku vendos per :

1. Bilancin vjetor
2. Ndryshimet ne statut.
3. Shtimin dhe pakesimin e kapitalit themeltar.
Emerime dhe shkarkime te administratorit
Emerimin e ekspertit kontabel
6. Hapjen e degeve apo filialeve apo perfaqesive te saj.
7. Shnderrimin e shoqerise ne nje forme tjetër te saj.
8. Zgjatja e afatit te aktivitetit te saj.
9. marrjen dhe largimin nga puna te drejtorit te pergjithshem
10. Vendime per marrjen pjese ne shoqeri te tjera
11. Aprovimin e rregullores se shoqerise
12. Kalimin e shoqerise ne likujdim si edhe te mbylljes se bilancit jashte likujdimit.

NENI 9

Vendimet e marra nga Ortaku i Vetem ne mbledhjet e zakonshme dhe te jashtezakonshme, ne perputhje me kete statut jane te detyrueshme dhe te zbatueshme per te gjithë. Mbledhja e Ortakut te vetem behet te pakten nje here ne vit. Lajmerimi ne pjesmarrjen e kesaj Mbledhje duhet te behet 30 dite para dates se caktuar si dite e mbledhjes. ne lajmerimin e mbledhjes duhet te jete ora, dita e vendi izhvillimit te mbledhjes si edhe do te caktohet rendi i dites per ceshtjet qe do te shqyrtohen ne kete mbledhje. ne mbledhjen e Asambnlese se Ortakeve mbahet nje proces verbal ne prezence te noterës. Ortaku i vetem ka te drejte te perdore librin e ortakeve dhe ka te drejte te marre ekstrakte te tij te vertetuara rregullisht nga Noterja.. Ortaku i vetem mbledhjet e zakonshme iben cdo vit brenda 1 muaji nga mbyllja e veprimtarise ekonomike te shoqerise.

Vendimet per te cilat nevojitet unanimiteti jane :

1. Vendimet per shtimin apo pakesimin e kapitalit.
2. Shtimi i periudhes se kohezgjatjes se shoqerise.
3. Futja e shoqerise ne procesin e likujdimit perpara perfundimit te afatit te percaktuar per shkrirjen e saj.
4. Ndryshimet ne statut.

NENI 10

Ortaku ka te drejte te marre pjese ne aktivitetin e shoqerise ne menyre e percaktuar ne akt themelimin dhe ne statutin e shoqerise. te marre nje pjese te fitimeve te aktivitetit te shoqerise. te marre informacion mbi aktivitetin e shoqerise pa asnje pengese. Ka te drejte te beje kontrollin e librave te shoqerise me ane te nje kontrolli te specializuar, ne kete rast me shpenzimet e veta. te marre pjese nga pasuria e shoqerise qe do te rezultojë si aktiv ne bilancin e likujdimit te shoqerise. Ortaku ka te drejte qe te transferoje lirisht jashte shtetit ne valuten qe deshiron, ate pjese fitimi qe i takon. Po keshtu edhe kundravleren e kuotave

Edhe Beqej

te kapitalit qe eventualisht mund te shese, apo vleften qe i perket asaj ne rast se shoqeria do te likujdohet.

NENI 11

Administratore i Pergjithshem i shoqerise eshte Ortakja e vetme zj.Alma KRAJA e cila kryen veprime ne emer dhe per llogari te shoqerise.

Ne marredheniet me te tretet Ortaku i vetem ka te gjitha kompetencat per te kryer veprimet ne interes dhe per llogari te shoqerise dhe qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise. Ortaku i vetem eshte pergjegjes individualisht dhe solidarisht ndaj shoqerise ose ndaj personave te trete kur gjate veprimeve te tyre shkelet ligji, akti i themelimit dhe statuti i shoqerise ose per shkelje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

NENI 12

Marredheniet e punes me te punesuarit prane shoqerise rregullohen me kontrate individuale qe do te lidhen me sejcilin prej tyre ne baze te ligjeve ne fuqi dhe kodit te Punes.

NENI 13

Kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar i emeruar per tre vite financiare me mundesi rizgjedhje. Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset me te njejta kondita si emerimi, ne rast se verehen gabime ne punen e tij gje qe e ben te pmundur kryerjen e detyres.

KREU III


MARREDHENIET EKONOMIKE FINANCIARE

NENI 14

Viti financiar fillon me date 01 Janar dhe mbaron ne date 31 Dhjetor te cdo viti. Llogarite vjetore, raportet dhe operacionet e vitit financiar e raportet e vecanmta te hartuara nga Ortaku i vetem dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga Ortaku i vetem.Miratimi i bilanceve mbi veprimtarine vjetore behet brenda muajit mars te vitit pasardhes.

NENI 15

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te fitimit, Ortaku i vetem percakton pjesen e fitimit qe i takon , pasi te jene zbritur shumat e lena menjane per fondin rezerve te



domosdoshem, ajo pjese qe mbetet nga fitimi pasi te jete zbritur pjesa qe do te kaloje me fondin rezerve, pjesa per fondet e tjera eventuale dhe pasi te jene likujduar te gjitha detyrimet tatimore, ju perket ortakëve te cilet kane te drejte ta disponoje teresisht.

NENI

16

Llogarite ekonomike dhe ato kontabel mbahen ne Shqiperi, ne leke ose ne valute te huaj. Vepimtaria ekonomike mbahet ne baze te akteve ligjore dhe nenligjore te dala per kete qellim dhe qe mbeshtet ne aktivin dhe pasivin qe detyrimisht do te pasqyrohen ne bilancet e perpiluara nga ekspertet kontabel te autorizuar te cilet mbajne pergjegjesi ligjore me pune e tyre. Shoqeria me qellim qe te lehtesoje punen dhe te beje sa me shpejt pagesat me te tretet do te hape llogari bankare ne nje nga bankat qe jane te njohura nga Shteti Shqiptar, vendase ose te huaja.

KREU IV

ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA, LIKUJDIMI

NENI

17

Me mbarimin e afatit te percaktuar ne kontraten e themelimit, zgjatja e tij behet vetem me vensim te Ortakut te vetem . Ajo priset kur mbaron afati i percaktuar nga ortakut dhe ortakut nuk ka rene dakort qe te beje ripertitjen e ketij afati. Shoqeria mund te shnderrohet ne nje nga format e percaktuara dhe te kerkuar nga ligji.

NENI


18

Shoqeria tregtare hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e vendosjes per prishjen e saj. Per fillimin e ketij procesi Ortaku i vetem emeron nje likujdues i cili paraqet raportin e likujdimit, gjendjen e aktivitetit dhe te pasivitetit te shoqerise, mbi menyren e ndjekjes se operacionit te likujdimit dhe afatin e nevojshem per perfundimin e tyre. Ne fund te procesit te likujdimit Ortaku i vetem vendos mbi bilancin perfundimtar mbi aktin dhe rregullsin e likujdimit, mbi mbylljen e procesit te likujdimit te shoqerise.

NENI

19

Zgjidhja e mosmarreshjeve ndermjet ortakut apo ortakëve te futur ne kete shoqeri eshte percaktuar ne aktin e themelimit te shoqerise. Mosmarreshjet qe mund te lindin ndermjet shoqerise dhe te treteve lidhur me marredheniet kontraktuale qe shoqeria do te kete kujdes t'i perfshije ne secilen nga kontratat qe do te lidhe.



Ky statut formulohet ne 4 (kater) kopje me vlere te barabarte, nga te cilat njera depozitohet ne Zyren e Noterise, njera ne Gjykaten e rrethit Tirane, njera ne Zyren e tatimeve dhe kopja e katert mbahet ne dokumentat e shoqerise.

SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"AlbAtlas" sh.p.k.

ALMA KRAJA


Alma Kraja
Alma Kraja

REPUBLICA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 180 REP.NR. 14 KOL.

VERTETIM

Sot, me date 14.01.2001 (dymije e nje) para meje Noteres Violanda BECI me zyre rr."Durrësit" nr.37 Tirane u paraqit personalisht Alma KRAJA, e bija e Osmanit , e dtl.1965, lindur dhe banues ne Tirane, me pasaporten e saj me nr.0523950, madhore me zotesi juridike dhe per te vepruar e cila deklaroi se sa me siper eshte eshte Akt themelimi dhe Statut i shoqerise "AlbAtlas" sh.p.k. te perpiluar jashte kesaj zyre sipas vullnetit te saj te lire e te plote dhe e nenshkroi ne pranine time dhe une Noterja e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE
VIOLANDA BECI



ve

Violanda Beci

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

VERTETIM

Vertetohet se z.ALMA KRAJA ka derdhur prane kesaj zyre shumen prej 100.000 leke (njqint mije) shume e cila perfaqeson kapitalin fillestar te shoqerise "AlbAtlas" sh.p.k. ne krijim e siper.

Kjo shume do te qendroje e derdhur prane kesaj zyre deri ne momentin e paisjes se kesaj shoqerie me vendimin e gjykates per regjistrimin si person juridik.


NOTERE

NOTERE
VIOLANDA BECI



Alma Kraja

12




By M. Bexha
19.01.2001
GEN. 2001

KERKESË

KERKUESI: Alma KRAJA, e bija e Osmanit , e dtl.1965, lindur dhe banues ne Tirane, me pasaporten e saj me nr.0523950, madhore me zotesi juridike dhe per te vepruar

BJEKTI: Regjistrimin si person juridik te shoqerise " AlbAtlas" sh.p.k. ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992.



PER KOMPETENCE

GJYKATES SE RRETHIT

TIRANE

Une kerkuesja jam banore e Tiranës dhe kerkoj te ushroj aktivitetet privat si person juridik me shoqerine "AlbAtlas" sh.p.k. me seline e saj ne Tirane, rr." M.Peza", duke qene une Ortake e vetme e kesaj shoqerie, e cila do te kete aktivitetin e saj ne fushen e : negocimit dhe organizimit te turizmit si agjensi turistike te te huajve ne vendin tone dhe te vendasve ne vendet e huaja, perfshire ketu, hotelerine, ushqimin dhe transportin, duke bashkepunuar me agjensite e tjera turistike te vendit dhe te huaja, shitblerjen e biletave per udhetime ajrore , tokesore dhe detare, sherbime rent a car, si edhe aktivite te tjera qe do te konsiderohen te pershtatshme per zhvillimin e shoqerise Kapitali fillestar e kesaj shoqerie eshte 100.000 leke, me nje kohezgjatje te aktiviteti deri 10 vjet .

Ne keto kushte po ju drejtohem juve si gjykate e rrethit Tirane qe me vendimin tuaj te vendosni regjistrimin e kesaj shoqeri si person juridik.

KERKUESE

ALMA KRAJA


Alma Kraja
Alma Kraja

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NR. 189 REP.

VERTETIM

Sot, me date 19-01.2001 (dymije e nje) ditën e Hene para meje Noteres Violanda BECI me zyre rr."Durrësit" nr.37 Tirane u paraqit personalisht, Alma KRAJA, e bija e Osmanit , e dtl.1965, lindur dhe banues ne Tirane, me pasaporten e saj me nr.0523950 madhore me zotesi juridike dhe per te vepruar e cila deklaroi se sa me siper eshte sipas vullnetit te saj te lire e te plote dhe e nenshkroi para meje rregullisht dhe une Noterja e vertetoj sipas ligjit.

NOTERE
VIOLANDA BECI



Violanda *per*

Per vleren e aktit kushtetues
herkessa
me
22/1/2001
Permane
Permane
Doff
Doff